

Revistë periodike, letrare, kulturore, politike

# NACIONAL

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë  
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com

## Si u mohua Nënë Treza nga regjimi komunist?

Gjatë udhëtimit në Europë, në Itali Nënë Tereza u takua me të vëllanë Lazrin, Kishte dëshirë të takonte edhe nënën dhe të motrën që tashmë jetonin në Tiranë.

Nga Vilhelme Vranari

faqe 5



## Gazeta "Drita" e Manastirit (1911-1912)

Gazeta "Drita" e Manastirit ishte fletushkë politike e shoqërore gjuhën shqipe që botohej në Manastir me Alfabetin e Stambollit.

Nga Prof. Dr. Nexhat Abazi

faqe 21



## EDITORIAL

### Idea Nazionale

Nga Dr. Vehbi Miftari

Ditë më herët, pas përplasjeve dhe debatëve të nxehta mes forcave politike, Parlamenti Evropian artikuloi me vendosmëri një premisë politike për funksionim të institucioneve të përbashkëta evropiane, duke përligjur paraprakisht atë që presidenti çek, Klaus, nuk po lejoi ta përligj askush: Traktatin e Lisbonës dhe krijimin e institucioneve të fuqishme evropiane. Natyrisht, ai nuk e bëri këtë duke votuar traktatin tashmë të mbetur peng nga orientimet nacionale, sepse tek e fundit nuk është Parlamenti Evropian ai që mund ta përligjë traktatin me votim, ndryshe s' do mend se ai do ta bënte që herët këtë. Por, ai e arriti "përligjen" e tij në një formë tjetër, po kaq të vështirë, mbase, sa edhe miratimi i traktatit: ai arriti që duke i anashkaluar pikëpamjet nacionale të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilët mbronin teza të fuqishme pro identitetit të tyre nacional, ta refuzonte debatin për çështjet nacionale në parlament, duke i vendosur politikën e përbashkëta evropiane dhe forcimin e institucioneve të përbashkëta përmbi debatet për relacionet politike mes forcave të ndryshme të vendeve anëtare!

Vendimi u përshëndet, përveç të tjerëve, edhe nga shefi i grupit parlamentar të EPP-së (Partisë Popullore Evropiane), z. Joseph Daul. E, z. Daul është shef i grupit të forcave të djathta politike, i cili ka numrin më të madh të ulësve në këtë parlament. Ai e përshëndeti miratimin e heqjes së debatit nacional në parlamentin Evropian si mundësi për mosluftim të oponentëve politikë për shkak të politikave nacionale. Por, nëse kemi parasysh se janë pikërisht partitë e djathta ato që e mbështesin mundësinë e debateve të fuqishme për

Vijon në faqen 4

Gjithçka nga ceremonia e dhënjes së çmimit prestigjioz për letërsinë

# Kadare merr çmimin "Princi i Asturias"

faqe 2-3



## Në BRENDËSI

### Gropa

Tregim nga Herta Myller

faqe 8

### Zemra të kryqëzuara

Poezi nga Skënder Sherifi

faqe 6

### Urtësia e Ana Eliotit

Studim nga Gjekë Marinaj

faqe 7

### Arrestimi

Ditar nga Prof. Sami Repishti

faqe 11

### Poezi nga:

Muhamed Kërveshi

Bardhyl Maliqi

Ilir Pajo, Mevlud Buci

faqe 114-17

### Qorri

Tregim nga Volter, përkthyer nga Genc blloshmi

faqe 8

### Dita e vrasjes së Azemit

Roman nga Ilirjan Sadikaj

faqe 10

### Krahina

Tregim nga Qazim D. Shehu

faqe 22

### "Frika nga atdheu"

Kritikë nga kliton Nesturi

faqe 13

## MREKULLIA E NATYRES SHQIPTARE!



## Nobelisti Italian Salvatore Quasimodo

Si poet i vjetër dhe mendjemprehtë, Quasimodo përdor një gjuhë hermetike dhe të mbyllur që të munda të përcaktojë periodikisht motive të tilla si zakonet dhe traditat siçiliane.

faqe 12



Romani "Bindja", dëshmi e problemeve sociale të Anglisë së fillim shekullit të 19-të

# URTËSIA TRIUMFUESE E ANA ELIOTIT



Në foto: Gjekë Marinaj

Në romanin "Bindja" pëlqimi për veten dhe të tjerët pasohet nga vlera që e bëjnë karakterin e Anës edhe më të dashur. Ajo e sheh shoqërinë si ajrin që e rrethon për të mbijetuar, sado i ndotur qoftë ai, asaj i duhet ta pranohet.

Nga Gjekë Marinaj

Në fillim të shekullit të 19-të, Anglia duhej të merrej me disa çështje të rëndësishme sociale, të cilat kishin tërhequr vëmendjen e disa shkrimtarëve dhe poetëve të asaj periudhe, midis tyre edhe Jane Austen-i. Meqë tabloja e romanit "Bindja" (*Persuasion*), lidhet me periudhën e romanticizmit anglez, nuk ishte e zakonshme të gjeje personazhe të trilluara, si Ana Eliot-i të zinin vendin kryesor në atë që quhet romani i moralit që shpesh herë e gjeje në veprat e Jane Austen-it. Ndoshta kritikët u tërhoqën nga faktet historike të asaj periudhe dhe sipas përpjekjeve për të interpretuar çdo hollësi të romanit, deri diku nuk dalluan tablonë e plot. Ata nuk arritën ta qasnin romanin "Bindja" si romani për vështirësitë e jetës së Ana Eliot-it, ku mësohet se në fund triumfi i saj nuk është rastësi, por sukses i merituar, i orkestruar me mjeshtëri nga krijuesja e saj nga Jane Austen.

Romani "Bindja" është më shumë se një roman i shkruar me elegancë, është pasqyra e tablove të jetës dhe e dëshmisë së problemeve sociale të Anglisë së fillim shekullit të 19-të. Historia e letërsisë ka vërtetuar se shkrimtarët i janë nënshtruar shumë ligjeve të shkruara e të pashkruara që presin t'i binden lexuesit me respekt dhe dinjitet. Austen, e cila ishte në dijeni të ligjeve të tilla, shkroi romanin "Bindja" deri diku për t'i zënë me punë kritikët në vazhdimi. Kjo është një nga arsytet se përse shumica e kritikëve të sotëm e shohin shpirtin e romanit prej një këndvështrimi krejt të ndryshëm nga njëri-tjetri. Le të përmendim vetëm dy-tre prej tyre: A. Walton Litz, kërkoi t'i bind lexuesit se vëmendja duhet të "... tërhiqet nga vlera të tjera që Austen u jep skenave të natyrshme (faqe 217)." Merilin Butler përdor fjalën "tradicionalist" si njëherë prej fjalëve kyçe, për të shprehur idenë se tek romani "Bindja", Kapiten Frederik Wentworth prek një nga temat studimore klasike të njeriut me mendje të rinovuar prej ideve konservatore (faqe 224). Vetëm po të lexoni kritikën e titulluar "Pasuria morale dhe analiza mbi romanin (Bindja) të Jane Austen (faqe 265)," nga Robert Hopkins kuptojmë edhe më shumë orientimin që kërkoi t'u japë lexuesve. Anne W. Astell në kritikën e saj, "Shkollimi i Ana Eliot-it: Filozofia e romancës tek romani 'Bindja' (faqe 27)," zbrërthen interpretimin e bashkë kritikëve si: Richard Simpson tek (Review), C. S. Lewis tek (Një letër) dhe D. D. Devlin tek (Jane Austen) që mbeten "... zhgënjyese për një sërë arsyesh (faqe 247)." Nga ana tjetër shumica e lexuesve do ta shfrytëzonin shqetësimin e Ann W. Astell, për të cilën kritikët "... gjithmonë kanë pasur vështirësi në përjasjen e romanit "Bindja" të Jane Austen sipas këndvështrimit pedagogjik (faqe 274)." Ndaj qëllimet e saj trilluese tejkalojnë atë çka synon ta quajmë, se shkollimi dhe vet urtësia e Ana Eliot-it janë të rëndësishme për problematikën e jetës, jo sepse i zotëron, por sepse i zbaton këto vlera me mjeshtëri në fusha të ndryshme, siç është: muzika, poezia, mendimi, falja, vet flijimi dhe dashuria. Shkrimtarët e mëdhenj kanë për detyrë t'i kushtojnë vëmendje nevojave të veçanta të person-



Portret i shkrimtares Jane Austen

azheve. Ndaj nuk është e vështirë të mendojmë se Austen ka bërë zgjedhjen e duhur duke e pajisur protagonistin e romanit "Bindja" të jetë e interesuar për dëgjimin dhe interpretimin e muzikës. Në kapitullin e gjashtë, Ana vë në përdorim njohuritë e saj për t'u vet-kënaqur ndërsa luan në piano në Shtëpinë e Madhe (*Great House*), atje ku ka filluar festa, ku "vajzat kërcëjnë të shfrenuara (faqe 32)." Edhe pse ishte me familjen dhe kushërinjtë, tregoi pjekuri me durimin e saj deri sa i thanë t'i binte pianos. Kur ia kërkuan diçka të tillë, "Ana e cila kishte më shumë qejftë interpretonte muzikë, se sa të kërcente, luajti muzikë popullore për një farë kohe plot dashuri e cila tregonte gjithnjë e më shumë potencialin e saj muzikor, që nxitej nga zoti dhe zonja Musgrove ku në më të shumtën e rasteve merrte përgëzime si: "Të lumtë, zonjushë Ana! Shkëlqyer! Zoti t'i bekoftë ato gishtat e vegjël që fluturojnë...!" (faqe 32)." Për më tepër ajo interpretonte muzikë që të tjerët të kërcenin dhe kjo ishte vetëflijuese. Muzika për të ishte forca shpirtërore që e mbronte për të kapërcyer vështirësitë e jetës, ishte pikërisht ajo që nuk e zhgënjente kurrë. Dëgjimi dhe interpretimi i muzikës ishte një nga format për të ekuilibruar zhgënjimet, e mbi të gjitha atë të vdekjes të së ëmës. Dashuria për poezinë dhe njohuritë për prozën i dhanë Anës një tjetër mjet për të luftuar jo vetëm vetminë e saj, por edhe atë të Kapiten Benwickut, si dhe dhimbjen për humbjen e bashkëshortes së tij. Pasi zbuloi se Kapiten Benwick-u lexonte më shumë poezi për të ruajtur paqen shpirtërore, Ana Eliot e këshilloi të lexojë më tepër prozë,

pasi e dinte se poezia do të ishte si marrja e barnave të tepërta për trupin dhe shpirtin. Austen e shfrytëzon këtë episod, jo vetëm për të treguar se Ana Eliot është e shkolluar dhe me shumë njohuri në lidhje me forcën e letërsisë, por edhe sepse ajo është gati ta jetësojë atë për vete, miqtë dhe shoqërinë.

Për Ana Eliotin si për çdokënd tjetër, shoqëria nis nga vetja dhe familja. Ajo e dinte më së miri se nuk kishte të bënte fare me krizën ekonomike që pësoi i ati pas vdekjes së të ëmës, por në të njëjtën kohë pati ide të qarta për perceptimin e shoqërisë në lidhje me situatat. Që në kapitullin e parë rrëfimtari e përshkruan Sir Walter Eliotin si "... një burrë i cili qoftë edhe për kënaqësinë e tij, nuk luante asnjë libret, vetëm se kishte titull fisnikërie (faqe 3)." Ndaj Ana nuk donte që i ati të ishte në qendër të thashethemeve të qytetit. Ajo e respektonte gjithmonë babanë e saj dhe ndryshe prej tij, do të bënte gjithçka, vetëm që ta shihte të lumtur. Jane Austen e veshi Anën me forcën e arsyes dhe dëshirës për ta mbajtur në jetë, duke pasur plotësisht parasysh se:

"Kur ishte gjallë Leidi Eliot, kishte rregull, kontroll dhe kursime, të cilat mbanin të ardhurat e tij, por së bashku me të vdiqën edhe këto zakone të mira dhe që nga ajo ditë shpenzimet sa vinin e rriteshin gjithnjë e më shumë. Për të asnjëherë nuk ka qenë e mundur të shpenzonte më pak. Sir Walter Elioti nuk kishte bërë asgjë, përveç se i duhej të sillej me guxim, e njëkohësisht ashtu siç ishte i pafaj, jo vetëm që i rriteshin borxhet, por i llogariste ato edhe më shumë, aq

sa ishte e kotë të përpiqeshe t'i fshije, e për më tepër nga vajza e tij. (faqe 7)." Vetëm nga ky fragment dalin prova të mjaftueshme prej kritikëve letrar që përpiqen t'i kuptojnë situatat përmes syve të Anës. Është e qartë se ajo nuk ishte pjesë e shqetësimit, por u bë pjesë e pandashme e zgjidhjes, kur Leidi Rasell "... hartoi planin financiar, ... bëri llogaritë e duhura dhe mbi të gjitha u këshillua me Anën, të cilën askush nuk do ta besonte (faqe 9)." Jane Austen i dha Anës ndjenja, mendime e sjellje të sinqerta, në mënyrë që lexuesi të mund të lidhet më shumë me vendimet, mendimet dhe dashurinë për Kapiten Wentworth-in. Zonja Kroft i tha Anës "Ishe ti dhe jo motra jote, prandaj tani e kuptoj, përse im vëlla kënaqej të përshatej me jetën e fshatit (faqe 33)." Ndaj ajo u soll mirë, braktisi ndjenjat e saj, e prishi fillin e bisedës se nuk do të fliste me Frederikun, por me të vëllanë Eduardin, vetëm për të mos prekur emocionet e zonjës Kroft. Zonja Kroft kishte qëllim t'i jepte lajmin se Frederiku ishte martuar ashtu sikurse pritej, e cila i la një shije të keqe shpresave të Anës se një ditë do të bashkohej me Kapiten Wentworth-in. Përsëri kuptoi se sipas situatës, pavarësisht dhimbjes, jeta duhet të shihet sipas këndvështrimit të dikujt tjetër dhe ajo zgjodhi heshtjen në vend që t'i përgjigjej zonjës Kroft.

**Në romanin "Bindja" pëlqimi për veten dhe të tjerët pasohet nga vlera që e bëjnë karakterin e Anës edhe më të dashur. Ajo e sheh shoqërinë si ajrin që e rrethon për të mbijetuar, sado i ndotur qoftë ai, asaj i duhet ta pranohet.** Opinioni i shoqërisë se dashuria dhe martesja duhet të mbështeten tek paraja dhe lidhjet e hapura, sollën pasojë negative në dashurinë, me Kapiten Wentworth-in. Edhe pse Leidi Rasell e bindi Anën t'i shpërfillte ndjenjat për kapitenin dhe t'i jepte fund lidhjes së parë, nuk ia vlente fajësimi, sepse mbi gjithçka kishin ndikuar shoqëria dhe gjykimet. Ana ishte në gjendje të kuptonte rëndësinë e këshillave të Leidi Rasell-it, duke e ditur se sillej si nënë me të dhe e fali për pasojat e pa dëshirueshme. Për ta kuptuar më mirë këtë episod, le të lexojmë më tej:

"Kam menduar rreth së kaluarës, dhe kam provuar paanësisht të gjykoj të mirën dhe të keqen, në lidhje me veten; dhe mendoj se e kam pasur drejt, sepse kam vuajtur shumë më tepër, aq sa ndihesha mirë se m, kishte këshilluar një mikeshë që do ta kisha dashur më tepër se asnjëherë tjetër. Për mendimin tim, ajo ishte si një prind. Gjithsesi mos më detyroni të lajthish. Nuk po them se ajo nuk gaboi me këshillat. Ndoshta ishte njëri prej atyre rasteve, kur këshilla e mirë apo e keqe përcaktonte pasojat dhe po t, isha n, vend t, saj nuk do t'i kisha dhënë, përveç se në raste të ngjashme. Por mendoj se ia vlente t'i bindeshe dhe po të kisha vepruar ndryshe, do të kisha vuajtur më shumë me mbajtjen e fejesës, siç bëra me prishjen, sepse do ta kisha pranuar me vetëdije. Ndaj përderisa kam një ndjesi të

Si u vra pabesisht nga osmanet dhe shovinistët grekë heroi i Permetit

# RIZA ISLAM VELCISHTI DËSHMORI I RILINDJES KOMBËTARE

Ismail Qemali, kur mori vesh lajmin e vrasjes së Riza Velcishtit, tha se “Shqiptarët gjithë herët kanë derdhur gjak për lirine e tyre, por asnjëherë për fat të keq nuk kanë fituar. Vrasja e pabese e heroit Riza Velcishti deshmon se Turqia ose do t’u japë lirinë, ose ajo vetë do të shkatërrohet.”

**Bardhyl Sami Greni – Velcisht- nipi**

Qëndrimi atdhetar i Riza Velcishtit e ka zanafillën nga frymëzimi patriotik i familjes së tij. Babai i tij Islam Hasan Velcishtit, njihet si nje luftetare i paepur qysh nga Lidhja e Prizrenit 1878-1879 (dega Frashër, Përmet) e mbledhur nën drejtimin e Abdyl bej Frashërit, në teqen bektashiane të baba Alushit. Aty u vendos për organizimin dhe mbrojtjen e kufijve jugorë gjithëshqiptarë, nga synimet e qeverisë greke, të lirë për veprim nga shteti osman etj.

Familja Velcishti ka qenë anëtare e denjë e kësaj Lidhje për zonën e Përmetit. Kjo familje mori përsipër përveç të tjerave sigurimin e trojeve të jugut të Shqipërisë, me 500 forca rezerviste luftëtarësh, në dispozicion të kësaj Lidhje, e cila bashkonte shumë patriotë të tjerë të trevës së Përmetit të kryesuar nga Abdyl bej Frashëri.

Familja Velcishti dikur e pasur, kur panë Shqipërinë të varfër, lanë dhe pasuritë e tyre duke i shkrirë që të gjitha për atdheun e tyre, Shqipërinë. Shqiptarët kërkonin të drejtat e tyre, por ata dëboheshin nga autoritet turke. Riza Islam Velcishti për këtë arsye dërgohet në Manastir, mbasi u dënua në Janinë me ulje përgjegjësie. Rizai nuk hoqi dorë nga e drejta për Shqipërinë. Ai në Manastir hyri në Komitetin e Fshehtë për Lirinë e Shqipërisë, që drejtohej nga Halit Bërzështa dhe Bajo Topulli. Rizai ishte një nga aktivistët më shembullorë.

## Prendjekja shovene

Kjo familje e madhe dhe e pasur iu nënështua një presioni dhe shkatërrimi të madh nga shteti turk. Vëllezërit e Islam Velcishtit u shpërbënë për këtë arsye, ata u shpërngulën nga fshati dhe sot nuk dihet, ndërsa pronat e tyre si brenda ashtu edhe jashtë kufijve të shtetit shqiptar u konfiskuan dhe u sekuestruan. Ndjekjet dhe persekutimet politike dhe psikologjike kundër familjes së Islam Velcishtit ishin të pamëshirshme, por edhe qëndresa e kësaj familje ishte e madhe dhe konsekuente.

Riza Velcishti i biri i Islamit, mbasi kishte mbaruar shkollën plotësore greqisht në Përmet. Për zgjuarsin dhe mprehtësinë u emërua ushtarak në Janinë. ai pasi u dënua nga autoritet turke dhe u dërgua në Manastir, dhe duke ditur persekutimet që po i bëheshin familjes së tij në fshatin Velcisht, e luftoi armikun shekullor deri në fund të jetës së tij.

Mbas krijimit të cetës luftëtare kryengritëse në vitin 1906 të komanduar nga Riza Velcishti, i cili luftoi kundër garnizoneve turke ai bënte edhe një luftë kundër shovinistëve grekë. Këtë e shoqëronte me materiale propogandistike kombëtare.

Riza Velcishti nuk u përul edhe pse babanë e tij Islamin, për shkak të tij që ishte i bugosur në Janinë, investoi 100 napolona flori për luftën që bënte i biri Rizai, për çështjen kombëtare. Gjithashtu ai nuk pyeti edhe pse familja e tij e gjithë në Velcisht,



ishte internuar në Përmet.

Riza Velcishti, vec të tjerash ishte ngarkuar nga Komiteti i Manastirit të mbronte popullsinë shqiptare kishtare në zonën Shqerri të Përmetit, nga ndikimet e megaloidhesë greke dhe nga priftërinjtë shërbëtorë vendas.

Në këtë ruajtje Rizai kishte ndihmën e priftit patriot At. Stath-Melanit. Populli i Shqipërisë e mbajti dhe e ruajti Rizanë si birin e vet.

## Komploti osmano-grek

Organet turke të Janinës u vunë në veprim që Riza Velcishtitë asgjesohej me cdo mjet. Organizimi për vrasjen e tij u bë nga

Valiu i Janinës dhe shovinistët grekë. Ata arrestuan kunatin e tij, burrin e së motrës, Taulla Vrepoki i cili u mposht para tyre. Kështu autoritet turke dhe priftërinjtë e Përmetit, gjetën mënyrën që të vrasin tradhëtisht dhe pabesisht Riza Velcishtin me anën e Josif Sorropullit, coban në vendin e quajtur Peste Shqerisë.

Duke larë hesapet me Rizanë në vitin 1907, turqit lanë të lirë familjarët e tij të internuar. Ajo u mor nën kujdesjen e familjes Shkëmbi, (Qesarake, Kolonjë), njerëzit e gjyshes sime.

Vrasja makabër e Riza Velcishtit u mbajt e fshehur nga qeveria turke. Kjo vrasje u zbulua mbas 8 muajsh nga Cerciz Topulli e Mihal Grameno të ndihmuar nga prifti patriot At. Stath-Melani, i cili u vra po nga Josif Sorropulli më 1914 duke ia cuar kokën në Greqi.

Ismail Qemali, kur mori vesh lajmin e vrasjes së Riza Velcishtit, tha se Shqiptarët gjithë herët kanë derdhur gjak për lirine e tyre, por asnjëherë për fat të keq nuk kanë fituar. Vrasja e pabese e heroit Riza Velcishti deshmon se Turqia ose do t’u japë lirinë, ose ajo vetë do të shkatërrohet.

Pas largimit të osmanëve turq nga trojet tona, u shfaq një armik tjetër për shqiptarët, shovinizmi grek me gjithë ëgërsinë e tij.

Ushtria greke dhe mercenarët (andarët) vendas shqiptarë të fesë orodokse iu turrën popullsisë shqiptare myslimane në trevat e Jugut duke bërë krime duke shkatërruar gjithcka. Një nga këto viktima ishte treva e Përmetit, sidomos krahinat Dangëlli, Cerje e Dreshnicë.

Në ato kushte popullit iu desh të shpëtojë nga shfarosja. Djemtë shqiptarë të kësaj treve e luftuan me armë në dorë armikun e ri, shovinistët grekë. Këtu shkëlqen edhe djali tjetër i Islam Velcishtit, Ali Velcishti. Ali Velcishti, megjithëse në një moshë të re, me një grup shokësh, mbrojtën depërtimin e shovinistëve ( ushtrisë së tyre në Frashër, Cerje, Dreshnicë dhe u dha mundësi të largohen me shpejtësi në drejtim të Beratit dhe Vlorës ( të gjithë popullatës).

Familja e Riza Velcishtit, pas internimit, së bashku me popullsinë e kësaj treve, iu desh të largohet dhe të robëtohet në krahinat e fshatrave të tjera si në Skrapar, Berat, Fier, Vlorë. Ajo është kthyer në vendin e saj në Velcisht pas 16 vjetësh (1905-1921). Aty nuk kishte mbetur asgjë nga pasuria e tyre për të jetuar. Kjo familje u mbështet nga miqtë e saj, Izet Frashëri, Lame Mamaqi, Isuf Pogria etj. Shtëpia e Islam Velcishtit u dogj nga turqit dhe nga shovinistët grekë.

Duke qenë vazhdimësi e traditës atdhetare shqiptare familja e Sami Grenit e mbështeti pa rezervë Luftën Antifashiste Nacionalclirimitare, pa marrë parasysh vështirësitë e mëdha ekonomike të familjes. Kjo familje pas Clirimit u godit rëndë nga regjimi komunist i Enver Hoxhes, vetem pse ishte nje familje e madhe nacionaliste, bejleresh patriote.

Vijon nga faqja 7

tillë më lejohet të bëj autokritikë sipas natyrës njerëzore, ku nëse nuk gaboj, marrja e përgjegjësisë nuk i sjell dëme gruas. (faqe 164).”

Atëherë kur duhej, sakrificë u kthye në një nga mësimet fisnike që u bënë të njohura, si për Anën dhe për të tjerët. Megjithatë lajmi se Kapiten Wentworth-i ishte kthyer në Uppercross, trazoi emocionet dhe rinxiti shpresat, aq sa Ana ishte gati të ndrydhte qoftë edhe ndjenjat personale në emër të së motrës Meri, duke marrë përsipër të kujdesej për fëmijën që kishte dëmtuar kavigjiljen. Vendimi për t’u vetflijuar që të ruante paqen midis Merit dhe bashkëshortit të saj Çarlis, përforcuan më shumë karakterin e protagonistes s, romanit.

Që në fillimet e romanit nga jetësimi i mësimëve dhe urtësisë së Anës realizohet në mbyllje të tij përmbushja e dashu-

risë me Kapiten Wentworth-in. Madje edhe kritikët më të ashpër do të kishin pohuar se mirësjellja, urtësia dhe vetkontrolli janë pjesët më të mira të asaj që e quajmë “romantike”. Në fillim, rrëfimtari e siguron lexuesin se “nuk ka shfajësim për atë që zemra e Anës nis të rrahë, pa marrë parasysh veten e cila skuqej, sa herë mendonte që Kapiten Wentworth-i do të ishte i lirë. Ajo kishte ndjenja për të cilat vihej në siklet kur i merrte në konsideratë. Ato ishin më shumë se gëzim, ishin një gëzim i pakuptimtë (faqe 111).” Përveç ndjenjave të forta për Kapiten Wentworth-in dhe pendesës për gabimet që kishte bërë para tetë viteve, bëhet më e matur kur i afrohet atij. Nga ana tjetër, ai i njëjtte vlerat e saj, siç ishin zemërngrohtësia, ndershmëria dhe krenaria të cilat i vuri në jetë në çastet më të vështira dhe këto bënë që zemra e tij të jetë gati sërish, por kësaj radhe përgjithmonë, pavarësisht faktit se “kishte menduar ta harronte,

dhe se e kishte bërë të kryer atë veprim (faqe 161).” Ana pajiset me virtyte të shkëlqyera nga autori të cilat i vuri në përdorim në mënyrë inteligjente për tetë vjet rresht, ku si personazhi kryesor i romanit “Bindja”, detyra kryesore ishte të tregonte, se kur i përkushtohesh mirësisë dhe vet-urtësisë për të mirën e përbashkët, pavarësisht pengesave të jetës, në fund triumfon fati i mirë dhe ajo arrin të marrë Kapiten Wentworth-in. Madje edhe kur zgjodhi të ndahej nga jeta, Austen i dha jetë “... me elegancën e mendjes dhe mirësinë e karakterit, ku pavarësisht faktit, ajo u ngrit përtej opinionëve të kujtdo, se ishte një hiç, si me baba apo me motër, se fjalët e saj nuk kishin peshë, e cila e kishte më të lehtë të falte, sepse ishte veçse një Ana (faqe 5).”

**Përktheu nga anglishtja: Irena Papingji**